



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1131/1 Prot.

Tiranë, më 29. 07. 2019

V E N D I M

Nr. 99, Datë 29. 07. 2019

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 86, datë 19.07.2019, e shtetasit S. L., kundër ish Prokurorit të Përgjithshëm A. Ll. dhe Prokurorit të Përgjithshëm A. M., në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak të bindjes filozofike, gjendjes shoqërore dhe vendbanimit.*

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi shpjegon se, që nga viti 2013 ka qënë i emëruar në pozicionin e oficerit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më datë 07.01.2015, pa patur djeni me urdhërin nr. 10, datë 07.01.2015, të Prokurorit të Përgjithshëm A. Ll., është transferuar në të njëjtin pozicion në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lushnje. Duke qënë se ankuesi banonte në Tiranë, detyrohej të shkonte çdo ditë në vendin e tij të punës në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lushnje. Gjatë kryerjes së detyrës në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lushnje, nga prokurori A. H., mbështetur në ankesën e familjarëve të një viktime të vitit 1999, iu ngarkua hetimi i kësaj çështje të cilën e kishte pezulluar më parë prokurori A. Ll. Sipas ankuesit, nga ana e prokurorit i është dhënë ankesa bashkëngjitur me fashikullin e hetimeve të kryera në atë kohë për ngjarjen, por pa i deleguar ndonjë veprim konkret. Pasi ka marrë fashikullin, ka konstatuar dhe i ka deklaruar prokurorit se pezullimi i kësaj çështje për mos zbulim të autorit përbënte një skandal në drejtësi dhe për këtë shkak i ka kërkuar në formë lutje të mos ia ngarkonte çështjen, për të mos patur konflikte me Prokurorin e Përgjithshëm A. Ll., pasi atë që kishte mbuluar ai më parë nuk mund ta trajtonte.

Pas këtij diskutimi, më datë 19.01.2017 ka lënë dosjen mbi tavolinën e prokurorit të çështjes. Më datë 23.01.2017 është njoftuar nga drejtuesi i Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Lushnje, Ç. Sh. se me urdhër nr. 20, datë 20.01.2017 do të transferohej në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe për këtë duhet të dorëzonte dosjet që kishte në hetim. Në këto kushte, ka dorëzuar detyrën si Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor të Lushnjes dhe të nesërmen është paraqitur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pukë. Për shkak se transferimin e bërë e ka konsideruar të paarsyeshëm dhe për shkak të vështirësive familjare dhe largimin nga familja në Tiranë, ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë këtë akt.

Me urdhërin nr. 133, datë 01.06.2017, Prokurori i Përgjithshëm A. Ll. ka urdhëruar largimin të ankuesit nga detyra e Oficerit të Policisë Gjyqësore në Pukë dhe në dispozitivin të këtij urdhëri nuk citohen arsyet e zgjidhjes së marrëdhënive të punës.

Këtë urdhër ankuesi e ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku dy gjykatës pasi dhanë dorëheqjen, i treti e dërgon për shqyrtim në Gjykatën Administrative Shkodër. Pasi e ka kundërshtuar këtë vendim në Gjykatën e Lartë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vendosi që t'ia kalojë për kompetencë shqyrtimin e çështjes Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pa shqyrtimit gjykata vendosi pranimin e pjesës së padisë, duke e konsideruar urdhërin nr. 133, datë 01.06.2017 të Prokurorit të Përgjithshëm A. Ll. si akt i paligjshëm dhe rrëzimin e pjesës tjetër.

Këtë vendimmarrje e S. L. e ka ankimuar në Gjykatën e Shkallës Administrative të Apelit Tiranë duke parashtruar dhe kërkuar praninë të plotë të kërkesë padisë. Kjo gjykatë në dhomë këshillimi datë 18.03.2019. vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë pa asnjë ndryshim, pra shfuqizim të urdhërit si akt të pavlefshëm. Mbi bazën e këtij vendimi datë 29.03.2019, ankuesi i është drejtuar me kërkesë Prokurorit të Përgjithshëm A. M., për shqyrtim të aktit të paligjshëm me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë duke bërë emërimin e ankuesit në pozicionin e Oficerit të Policisë Gjyqësore.

Në përgjigje të kërkesës, përfaqësuesja e Prokurorisë së Përgjithshme e çështjes në gjykatë P. G., me anë të shkresës nr. 626/5 prot., 18.04.2019, ka vënë në dijeni ankuesin se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, nuk e ka detyruar Prokurorinë e Përgjithshme ta kthejë në detyrë si oficer të policisë gjyqësore.

Përsa më lart, ankuesi ka pretenduar se largimi i tij nga detyra është bërë për shkak të bindjes filozofike, gjendjes shoqërore dhe vendbanimit.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, zbatimin korrekt të ligjit.

Pas shqyrtimit paraprak të saj, u konstatua se ankesa e depozituar pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna prej subjektit ankues, në lidhje me shkaqet e pretenduara dhe lidhjes shkakësore me trajtimin më pak të favorshëm.

- Për këtë arsye, më datë 22.07.2019, ankuesi mori takim me përfaqësues të Komisionerit për të vënë në dispozicion shpjegime lidhur me shkaqet e pretenduara dhe shpjegime të trajtimit të pabarabartë në raport me punonjësit e tjerë për shkaqet e pretenduara.

Sipas informacionit¹ të dhënë gjatë takimit datë 22.07.2019, lidhur me bindjen filozofike sqaroi se: *“...bindja ime dhe gjithë veprimtaria ishte nën moton ‘shërbej në drejtësi për të dhënë drejtësi’, për shkak të së cilës hasa vështirësi në marrëdhëniet e mia procedurale me eprorët, shumicën e tyre”*.

Lidhur me shkakun e gjendjes shoqërore ankuesi sqaroi se: *“...për vetë faktin se kam qënë gjithë kohës së shërbimit tim si oficer i policisë gjyqësore dhe hetues, jo vetëm pa një përkrahje apo lidhje shoqërore me personat me pushtet, qeveri, a politikë, por dhe në drejtësi, nuk mu mundësua emërimi si prokuror në sistem, e veç kësaj transferimet larg banimit kanë qënë të pa motivuara dhe pa shkak ligjor”*.

Lidhur me shkakun e vendbanimit ankuesi sqaroi se, duke qënë me vendbanim në Tiranë, nga viti 2002 e në vazhdim, brenda një periudhe 4 (katër) vjeçare, është transferuar nga Tirana, në Lushnje e më pas në Pukë. Në këtë kuprim, duke e larguar nga vendbanimi, ushtrimi i së drejtës prindërore është bërë më i vështirë për të. Veç këtyre vështirësive, ankuesi cilëson se, ushqimi, fjetja dhe gjendja e stresit i kanë rënduar edhe gjendjen shëndetësore.

Në përfundim të arsyetimit dhe informacionit të sipërcituar S. L., nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë fakt apo provë lidhur me shkaqet e pretenduara të diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të*

¹ U mbajt procesverbali datë 22.07.2019, i administruar në dosje.

ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument, indicie apo provë, për të vërtetuar shkaqet e diskriminimit, apo trajtimin në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese në raport me persona të tjerë.

Neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Në rastin konkret, ankuesi duhet të identifikojë një cilësi apo karakteristikë personale për të cilën pretendon se është trajtuar në mënyrë të pafavorshme.

Nga ana e ankuesit është paraqitur informacion mbi problematikën që ka lidhur me transferimin dhe largimin e tij nga detyra në shkëlqje të legjislacionit, por nuk ka paraqitur fakte dhe prova apo shpjegime për të provuar shkaqet e pretenduara të diskriminimit dhe për të provuar se trajtimi i pabarabartë i tij është bërë për shkak të cilësive të veçanta që ai ka.

Për sa më sipër, Komisioneri vëren se, S. L. mund të jetë vënë përpara veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm, por në bazë të rrethanave të shpjeguara prej tij, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes me pretendim diskriminimi.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit S. L., për shkak se është haptazi e pabazuar dhe nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

Robert GAJDA

KOMISIONER

(Shkaku: Bindja filozofike, gjendja shoqërore dhe vendbanimi)

(Fusha: Punësim)